

MUSTAFA RUMANI

BIBLIOTEKA
SHTETIT

85H-1
R 94

NE ATO
MALE
DHE
BREGORE



RAPSODIKE



VARGJE



8JH-1
1294

MUSTAFA RUMANI

NË ATO MALE DHE BREGORE

Vargje rapsodike



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK, Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1976

RILINDASVE

Kujtojmë rilindasit tanë
për dituritë që na dhanë
dhe porositë që na lanë
për të ndriturë vatanë.

Kujtojmë ata atdhetarë
që nga goja nxorën ar
për kombin shqiptar
dhe gjuhën që t'vij mbarë.

Kujtojmë Hoxha Tasimin,
Avdul, Saminë e Naimin,
që përhapën përparimin,
shkollat shqipe dhe arsimin.

Andon Zakon dhe të tjerë,
që ishin burra me vlerë,
me lavdi edhe me nder,
që s'harrohen asnjëherë.

NAIM FRASHËRIT

Nuk do të harrohet Naimi,
gojëmjalti e gjuhë bilbili,
patrioti e zemërtrimi.

S'harrohet ky vjershëtar,
ky i flaktë atdhetar
që ligjëroi me mall.

Që këndoi për lirinë,
Bagëtinë e Bujqësinë.
Skënderbeun e trimërinë.

Vjersh' e tija mori dhenë,
drit' e shpres' për mëmëdhenë
të fiton' lirinë e nderë.

O JU TRIMA TË DËGJUAR

Çerçizi me gjith' Mihalë¹⁾
ishin dy trima të rrallë,
Bajrami me Hito Labnë²⁾
bimbashin turk e vranë.

Viti nëntëqint e tetë
kapetan Çerçizi vetë
doli maleve me çetë,
me trimat e tij me fletë.

Te rrapi në Mashkullorë
vazhdoi lufta dhjetë orë,
trimat me armë në dorë
luftuan me një taborr.

Trimat e Çeços me famë,
s'e lëshuan istikamë,
nam në Mashkullorë lanë
nder i madh ish për vatanë.

1) Mihal Gramenoja

2) Bajram Pergji dhe Hito Labi, shokë armësh të Çerçiz Topullit. Vra-
në bimbashin turk në Gjirokastër.

VITI 1911

Nëntëqint e njëmbëdhjetë
Rreme Rushiti me çetë
nëpër kodra, nëpër brigje,
nëpër kreshta, nëpër shtigje.

Në Qaf' të Smartës te qarri
krisi pushka, u ndez zjarri,
u ngren' djemt' e Shqipërisë
në luftë kundër Turqisë.

Muharremi trim me fletë
mbi armikun vret e pret,
për të ruajtur vatanin
luftoi dhe me junanin.

Bamatat, nën Delvinë
luanët zunë pusinë,
djemtë trima t' arbëreshit
Konispol' e Kurveleshit.

Shovinistët me luft' i prinë
përmbi ta bënë kërdinë;
iknë ata të gjakosur,
porsi derrat e zgjebosur.

Morën rrugën tatëpjetë,
rruku-rruku, ran' në det,
të mundur, të shpartalluar,
fund e krye të dërrmuar.

NË VITIN DYMBËDHJETË

Në vitin dymbëdhjetë,
në nëntor njëzet e tetë
dielli shpërndau retë.
Ismail Qemali vetë
çau male, çau det,
erdh në Vlorë, në qytet.

Patriot Ismail Qemali
mendjelarti, zemërzarri
për liri i digjej xhani,
shpëtimtar e pat vatani,
shpresat popullit i ngjalli.

Në zemër të Shqipërisë
nga çdo anë e nga çdo vis
u mblodh lulja e burrërisë,
u ngrit flamuri i lirisë,
u hoq zgjedh' e robërisë,
u bë shpallja e pavarësisë.

KY VITI 1914

Ky viti katërmëbëdhjetë
s'ka për t'u harruar lehtë,
në histori do të mbesë.

Shovinistët e Greqisë
hyn' në jug të Shqipërisë,
dogjën fshatrat e kufisë.

Fshati im mbeti i shkretë,
tymi i zi mbuloi retë,
nga mali ikën kopetë.

Dhe dy gra plaka që mbenë,
Merushja me Merjemenë,
si qiri në zjarr i trenë,
të paharruara do jenë.

Ç'inat pati me 'to vallë,
q'i dogji në zjarr të gjallë?
Kudo që shkeli barbari
u dogj vendi u tha bari.

Muharremi¹⁾ me një çetë
në çdo fshat shkoi vetë,
shoi zjarret me të shpejtë.

Patriotin Alush Taka²⁾
s'e trëmbi zjarri dhe flaka;
priti sa e zuri nata,

fluturoi e u bë erë
shkoi te trimat e tjerë,
bënë luftë të paprerë.

Këta burra patriotë
i kish rritur kjo tokë,
i kujton populli sot.

-
- 1) Muharrem Rushiti, patriot nga fshati Koskë. Së bashku me çetën e tij luftoi kundra shovinistëve grekë.
 - 2) Alush Taka, patriot nga fshati Konispol. Ishte zëvendëskomandan i çetës së Muharrem Kocjotit.

SELAM MUSAI

Selami nga Salaria
me gjithë shokët e tija,
n'ato brigje, n'ato majë,
i vuri të huajt përpara.

Tejpërtej Malit të Gjerë,
i la të vrar' e të prerë,
luftoi ballë për ballë,
si Skënderbeu me pallë.

Flit' Selami, zemërtrimi,
u thoshte djemve: Ku jini,
frikë nga plumbi mos kini,
të gjallë me dorë i zini.

Dhe në luftën, më njëzetë,
Selam Musai me çetë,
sulmoi përpara vetë,
për në Vlorë, në qytet.

O Selam, zemër me çika,
n'ato qafa, n'ato gryka,
breshkaxhinjt' i zuri frika,
nga sëpata dhe nga thika.

Gunën përsipër e shtrove
e përmbi tela kalove,
si shqiponjë u lëshove,
pipinot seç i tmerrove.

KUJTON POPULLI SALINË¹⁾

Në Sarandë e në Delvinë
dike në gjithë atë krahinë,
në gojë e mbajnë Salinë
për guximin e trimërinë.

Lart në Delvinë kur doli,
kapetan Saliu foli,
pyeti ku është Thimio Loli²⁾,
në ferra fshehur te gjoli.

Shpejt në Krane arriu.
Ku të vente Thimio ziu,
rrrotull në ferra si miu,
nga frika gjaku i ngriu.

1) Sali Murati.

2) Thimio Loli, agjent i vjetër, i cili me çetën e tij terrorizonte fshatrat e rrëthit të Sarandës.

LUFTA E VLORËS

Lufta e madhe më njëzetë
tundi botën si tërmet
dolën djemt' e arbëreshit
të luftojn me pallë sheshit.
U derdh gjaku anembanë
fyt për fyt me italianë.
Atje sipër në Kaninë
po gjëmon e vetëtin
shqiptarët e bënë fora
çanin përpara me kordha.
Sulm, të çlirohet Vlora
bini, o ju lumtë dora.

KAPEDAN SALI VRANISHTI¹⁾

Sali Vranisht, kapedani,
i madh të kish dalë nami
se kiske zemër luani,
përbrenda të digjej xhani.

Që nga Vlora në Delvinë,
çdo qytet e çdo krahinë,
të gjithë e njihnin Salinë
se luftonte për lirinë.

Sali trimi, Sali kordha
s'të trembi shiu dhe bora
në dyfek të rrinte dora
gjithnjë ia bëje fora.

1) Sali Murati nga fshati Vranisht i Vlorës, Hero i Popullit. Luftëtar i shquar për liri. U dallua sidomos në luftën e Vlorës më 1920.

AVNI RUSTEMIT

O Avni, o trim i rrallë,
lule, lule, o Avni¹⁾ ,
në Paris vrate Esanë
se të kish shitur vatanë.
Ca të poshtër e zagarë
të zunë pritë e të vranë.
Populli i Vlorës ka dalë,
të ka pritur duke qarë,
Halim Xhelua guximtar
pranë varrit tha ca fjalë:
«Zogu është trahhtar,
hakun kemi për ta marrë.
Avni, lule e djalërisë,
ishe shpresë e vegjëlisë —
ylli i kuq' i lirisë.
Ty nuk të kemi harruar,
historia të ka shkruar.

1) Përsëritet pas çdo vargu

KONGRESIT TË LUSHNJËS

Luft'¹⁾ e Parë e mallëkuar
Shqipërinë e kish shkretuar
e kish ndarë e copëtuar.
Po në ato kohë të liga
doli Sulejman Delvina
me burra të tjerë trima.
Gjer në Lushnjë kanë ardhë
delegatët nga çdo anë,
vatanin për ta shpëtuar
nga armiqjtë e djallëzuar,
që mbi kokë i janë vërvitur
si zagarë të uritur.
Shumë vendime janë marrë
ta marrë vesh bota mbarë:
— Është një kombi shqiptar,
— Esat Pasha — trathtar.
— Breshkaxhinjtë italianë
Vlorën tonë pse e mbajnë?
Të largohen sa më parë!

1) Lufta e Parë Botërore (1914-1918).

TRIMIT TË MALËSISË,
BAJRAM CURRIT

Ç'kanë malet që vajtojnë?
Ç'kanë shpellat që lotojnë?
S'po e shohin më dragonë,
për liri ka rënë dëshmor.

O Bajram Curri me famë,
kudo luftove në ballë,
nuk e tunde istikamë,
e mbaje dorën në pallë.

Emri yt ka mbetë i gjallë,
Bajram, trim i malësisë,
yll i rrallë i burrërisë,
luftove kundër Turqisë
për flamurin e lirisë.
Luftove kundër Zogollit
tradhtarit dhe mizorit.
Bajram, s'të harron Shqipëria,
lart të ngriti Partia,
të ka shkruar historia.

KUR BËRI THIRRJE PARTIA

Kur bëri thirrje Partia
të çlirohej Shqipëria,
rroku armët djalëria.

Në ato kodra, në ato male,
u bë luftë çlirimtare
nga brigadat partizane.

Çdo krahinë në Shqipëri
ka luftuar për liri,
ka të sajën histori.

Dhe liria që u fitua
nga askush nuk u dhurua,
por me gjak u pagua.

DËSHMORIT VELIKO REXHO

Mârkati tê lindi, Mëllëzi tê tundi,
trim Veliko Rexho, që s'të mbante vendi.
Kur u vrenjtën malet e kushtimin dhanë,
rrëmbeve dyfekun dhe veshe gjerdanë.

Fjalën e Partisë, hape anembanë,
nën shembullin tënd, trimat morën malë,
s'harrohet korriku, drapëri mbet' n'arë,
ulën kokën lulet për ty, komisar.

Gjëmime dhe sulme pati ajo ditë,
gjaku ra mbi hekur, sfugjia në mish,
sulmove në ballë, flakë trimërie,
mbete në Delvinë, mbete yll lirie.

LUFTËS SË KONISPOLIT¹⁾

Prapa malit Shëndëlli
në qafa përmbi Lajli,
erdhën çetat me fuqi,
shtatë fshatra në kufi
po luftojnë me gjermanë
krah për krah me partizanë.
Për pesëdhjetë e pesë ditë
u zbardh nata u bë ditë.
Nëpër male dhe bregore,
dhe llogore më llogore
bëhej luftë popullore.
Luftë nga qielli e nga deti,
tundej vendi si tërmeti,
luft' e ashpër e paparë
në çdo breg e në çdo majë.
Tym e flakë në çdo anë
që çuditit gjithë dynjanë.
Gjermanët panë hatanë,
shumë prej tyre mbenë vrarë,

1) gusht-shtator 1943

kockat harcaye i lanë.
Disa shokë tanë të mirë
dhanë jetën për lirinë,
nuk i harron kjo krahinë.

DËSHMORËVE TË MURSISË

Vagalat, Mursi e Xarrë
juve të jeni krenarë
për trimat që janë vrarë.
Në male, në Konispol,
për liri mbetën dëshmorë:
Vangjel Kalua djal' i hollë,
Urani Bari shqiponjë,
Sotir e Kosta Deliu,
që ishin zemr njeriu:
Jani Korrua burr' i vuar,
Lalë Xharrua djal i zgjuar,
Koçua¹⁾ me Lonidh Delinë,
Kost Gërbura suferinë,
me gjak shkruan historinë.

1) Koço Rubija

ÇETËS SË BREGUT TË DETIT

Ku vate çeta e Bregut,
ç'u bënë trimat e dyfekut,
ku janë ata partizanë,
Zahua me Mitro Xhanë?

Në ato kthesa, në ato brigje,
në pozicione e në shtigje
për atdhe ata luftuan,
jetën për liri dhuruan.

Partia ju ka nderuar
në lapidar lartuar
kujtimi juaj i paharuar
me germa të arta shkruar.

DËSHMORIT FERIK ÇARÇANI

Ditën që erdhi gjermani¹⁾,
lule, o Ferik Çarçani,
çetës sonë i erdhi lajmi.
Partizanët si shigjetë
iu ngjitën malit përpjetë,
pararojë ishe vetë.
N'Konispol' e matanë
u hodhët përmbi gjermanë.
Ç'u ndez flaka anembanë,
me bomba dore i gritë,
përpara i vutë si dhitë.
Kur u hodhe mbi llogore
gjermanët i tmerrove
por plagë të rëndë more,
jetën pér liri dhurove.

1) Konispol, shtator 1943

DËSHMORIT
MEHMET BEJDO

Qaf' e Cjepurit matanë
u mbush plot me partizanë
vendosur në istikamë,
bëjnë luftë me gjermanë.
N'ato brinja, n'ato maja,
binte topi dhe mortaja
flak' e tym u bë dynjaja.
Po në luft' mbeti i vrarë
Mehmet Bejdua, trim i rrallë.
Mehmet Bejdo, trim i shquar,
mbete si yll i pashuar.

DËSHMORIT SADIK XHEPE

Sadik Xhepe, deli djalë,
e ngjite përpjetë malë.
— Fol, moj Qafa e Bekate,
Sadik Xhepeja ku vate?
— Doli malit partizan
për të çliruar vatanë.
Gjatë sulmit mbi Delvinë
e dha jetën për lirinë.
O Sadik, o sypetrit,
Partizanët të kanë qarë
edhe hakun ta kanë marrë.
Atë ditë sa të vrarë
Në gjermanë e trathtarë!
Delvina me gjak është larë.
Sadik fli i qetësuar,
se Atdheu është çliruar,
si e kishe ëndërruar.

TRE DËSHMORËVE NGA SHALËSI

Shalësi me krenari,
rrëzë malit në një gjë,
vend i bukur mrekulli,
gjatë luftës për liri
nxori djem delikalli¹⁾.

Më 21 korriku²⁾
u godit me zjarr armiku
në çdo anë tym e flakë
u vadit toka me gjak.

Për të çliruar Delvinë
u vranë ca trima të mirë,
partizanë nga kjo krahanë.
Dhe nga Shalësi tre dëshmorë,
trima të zgjedhur me dorë;
dy Bajot³⁾ nga një shtëpi,
ishin të dy kushëri,
Hyseni⁴⁾ djalosh i ri,
që dha jetën për liri.

1) Delikalli — i shkathët, i hedhur.

2) Më 21 korrik 1944 u bë sulmi i partizanëve të grupit IV për
çlirimin e Delvinës.

3) Rahim dhe Idriz Bajo, dëshmorë të fshatit Shalës.

4) Hysen Mahmuti.

DËSHMORIT KOMUNIST SEIT GAÇI

More urdhërin e shkove
për në Lurë, në veri,
diversantët të luftoje,
komisar me dituri.

Viti në dyzet e pesë,
muaji dhjetor më dy
populli ishte në festë
votonte me krenari.

Po bandat reaksionare
hynë brenda në kufi.

Forcat e Brigadës Parë
luftuan me trimëri,
vranë banditët, bënë kërdi.

Nga ne ra si trim i rrallë,
Seit Gaçi djal i ri,
shokëve që u ndodhën pranë
se ç'u la një porosi:
«Votoni, shokë, krenarë,
të rrojë nëna Parti!»

DËSHMORIT SELMAN XHALLARI

Në qafë të Likojanit
luftojnë djemtë e vatanit
i qëllon topi gjermanit
mes për mes istikamit.

Partizanët si luanë
s'e lëshuan istikamë
Selman Xhallari, or djalë,
plagë të rëndë ke marrë.

O Selman, ti e dhe xhanë
për liri e për vatanë,
emri yt në lapidar
do ndrisi si yll i rrallë.

DËSHMORIT MALIQ TENA

Urdhëri nga grupi
për në dislokim,
gjermanë e ballista
sulen me tërbim.
Në mal të Sminecit
u bë flak e tym,
shtatë partizanë
luftojnë me guxim.
Gjashtë kanë rënë
dëshmorë për liri,
u vra Maliq Tenua,
një djalosh i ri.
Po e qajnë shokët
me lotë në sy.

LEFTER TALOS¹⁾

Në Vurk kush doli i pari,
Lefter Talua, komisari.

O Lefter, o lule djalë,
fjalëmbël e zemërjarr,
gjithnjë ishe në ballë,
ishe djalë me dituri
të mbrujti nëna Parti.

Në Patos me Mustafanë²⁾
luftuat si dy luanë
dhëmb për dhëmb me gjermanë.
Në kala mbetët të vrarë.
Lefter Talo sypetriti,
kishe zemër komunisti
Partia lart të ngriti.

1) Lefter Talo, Hero i Popullit

2) Mustafa Matohiti, Hero i Popullit

KONGRESIT TË PËRMETIT

Kur pranvera buzëqeshi,
delegat priti Përmeti
se do të mbahej Kongresi.

Ata ishin shokë tanë,
sypatrembur, partizanë
vinin nga vija e parë.

Kongresi kur përfundoi,
vendimet komunikoi,
Komitetin formoi.

E mori vesh gjithë bota,
Kryetar¹⁾ ish Enver Hoxha,
trimi që e bëri fora.

Balli dhe Legaliteti
me gishta në gojë mbeti,
të përbuzur nga mileti.

Ca të huaj misionarë,
vinin rrotull si zagarë
u ikën shpresat që panë.

1) Kryetar i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar.

FASLLI RAMADANI¹⁾

Në një ditë plot hidhërim
u hap lajmi me nxitim:
Thanë se na u vra një trim.
Thanë se u vra kapedani,
trimi Faslli Ramadani.
Rreth e rrotull trupit të tija
roje nderi bën ushtria.
Te varrezat me dëshmorë
u mbush sheshi me kurorë,
për nderim i kanë bërë,
breshëri pushkësh kanë shtënë.

1) Faslli Ramadani Sulo, ish-oficer i Ministrisë së punëve të Brendshme, ra në krye të detyrës në gusht të vitit 1958.

KOMISARIT MUSTAFA MATOHITI

Nuk dëgjohet më bilbili,
luani që thosh: Ku jini,
armikut në kokë i bini,
frikë nga vdekja mos kini.

O Mustafa Matohiti,
ti kishe zemër graniti,
shpirt të zjarrtë komunisti,
se Partia të kaliti.

Mustafa, o lule djalë,
i kishe shokët të rrallë,
o komisari me famë,
s'ke vdekur po je i gjallë.

Ngrehu, Muço, dhe një herë,
ngrehu, të shikosh Atdhenë,
që lulzon me vrull përherë,
ndrit si dielli në verë.

KONISPOLIT¹⁾

Lart mali e karshi deti
nëpër qafa është qyteti,
pararojë në kufi,
lulëzon me krenari.

Majë kodrës, në Buar,
si një kopsht i lulëzuar
janë varrezat me dëshmorë
që qëndrojnë si kurorë.

Madhështor një lapidar,
shndrit porsi margaritar,
flet për luftën partizane
kundra kuçedrës gjermane.

Sa hije ka Konispoli,
fush' e madhe gjer te gjoli²⁾
ullinj dhe agrume mbolli
drit' e jetë Partia solli.

1) Kushtuar kooperativës së zmadhuar «Fitorja e Leninizmit»,
Konispol.

2) Gjoli i Butrintit.

Tetë fshatra të bashkuar,
kooperativë e zmadhuar,
punojnë me gaz e me gara
të shpërndarë nëpër ara.

TË DUA, FSHATI IM

Të kujtoj, o fshati im,
me të madh mallëngjim,
kur vishe me gjelbërim
ma mbush zemrën me gëzim.
Shtëpi të bukura, vilë,
lule, pemë e trëndelinë,
sipër mal e poshtë fushë,
kopshte me fiq e me rrush.
Plot me vreshta e plot me ara
çfarë të shikosh përpara;
uji i ftohët në të hyrë,
nuk ngopesh duke pirë.
Po të dalësh lart në brinjë,
nga çdo anë ndien verinë
këndon qyqja me bilbilë.
Po të dalësh nëpër rrëza,
të kënaq me zë thëllëza.
Në ata fusha, n'ato ara
traktori plugon përpara.
Të gjitha këto mirësi
I solli nëna Parti.

SHQIPËRI 30-VJEÇARE

- Ç'kanë malet që bubullojnë?
- Nga sondat që tej i shpojnë makinat përsipër shkojnë.
- Ç'kanë fushat që gjëmojnë?
- Janë traktorët që punojnë tokat drith' të prodhojnë.
- Ç'kanë kodrat që ushtojnë?
- Janë ushtarët që mësojnë shpejt' e saktë të qëllojnë.
Shqipëria kock' e fortë,
kala e kuqe në botë,
yll' i ndritur në Evropë,
fjal' e saja është top.

O VUNO, FSHATI ME FAMË

O Vuno, fshati me famë,
në Himarë ishe bërthamë,
ishe bazë e Partisë
për fitoren e lirisë.

Djemtë e tu, djema me halle
rrokën armët, morën male
të luftojnë me dushmanë.
Trathtarët me gjermanë
erdhë e të vunë zjarrë,
shumë trima jetën dhanë
për liri e për vatanë.

Zaho Koka¹⁾ me Kozmanë²⁾
Llambroja³⁾ e shumë të tjerë
që Vunoi i kish lerë.

O Vuno, ti dhe më parë
ke nxjerrë revolucionarë
të besës dhe atdhetarë,
gjak në vetull kanë marrë.

1) Zaho Koka, Hero i Popullit nga fshati Vuno.

2) Kozma Nushi, Hero i Popullit nga fshati Vuno.

3) Llambro Andoni, Hero i Popullit nga fshati Vuno.

KRAHINA JONË LULËZON

Kur qëndrova në Muzinë,
hodha sytë mbi krahinë,
të madh' e kishe gjëzimnë;
fush' e bukur në Delvinë,
ferm' e Vurgut gjer në Vrinë
baz' e fortë për bujqësinë,
ësht' hambar për Shqipërinë.

Atje tej në një luginë,
pranë fshatit Livinë,
hidrocentrali «Stalin»
telat e korentit vijnë
të ndriçojë vendi ynë.

Kur hodha sytë nga Stjari
portokalle bojë ari,
anekënd jeshilon bari,
gjelbërim dimër dhe verë
çelin lulet kurdoherë.

Që nga Shalësi në Mursi
vend i bukur mrekulli,
fush e madhe për çudi,
portokalle dhe ulli
të mbushin me krenari,
edhe kodrat përkarshi,

mbushur me dhën e me dhi.
Kjo krahinë ka lulëzuar
me shtëpi, shkolla ndërtuar,
jeta shumë ka ndryshuar.
O vëllezër, o vurgarë,
ç't'i kujtosh kohës së parë
kur beu të tërhiqte zvarë
dhe në pun' të merrte xhanë,
si shushunj' të pinte gjaknë!
O Parti, o tungjatjeta,
fjalët i ktheve në vepra,
të rrosh' sa të jetë jeta!

HODHA SYTË E SHIKOJ FSHANË

Dola lartë në një majë
hodha sytë e vështroj fshanë.
Çfarë të shikosh më parë!
Shtëpi të reja me radhë,
kopshte me fiq e me dardhë
dhe në qendër klub e furre,
edhe vatër për kulturë,
kopsht, çerdhe edhe shkollë
dyqan e Mapo çdo llojë,
në darkë po të hedhësh sytë,
nata të duket si ditë
gjëmon radioja anembanë
fjalët e Partisë shpérndan.
Dhe në fushë e në livadhe
djem e vajza si sorkadhe
s'u pushojnë duart fare.
ku ishim, ku jemi, — thashë,
zemra seç më doli jashtë.

KAM ZILI PËR BAGËTINË

Dua të jem bari
në fshatin tim të ri,
të vete me bagëti
me gëzim e krenari,
në Burime¹⁾, në vërrri,
t'i kullos më dashuri
n'ato pllaja me lajthi,
t'i kullos lart në mal
n'ato pllaja mbi Gusht'halë,²⁾
në faqe të malit Shëndëlli
atje ku fryn veri;
ujë të ftohtë të pi,
te lisat, te Maciani,³⁾
atje ku ngrihet stani
ku mërzen bagëtin' çobani.
N'ato të bucura hije
të ha e të pi me shije
fyllit me gaz t'i bije.
T'i këndoja jetës së re
plot me gaz e hare.
Të këndoja për Shqipërinë
për Enverin, për Partinë.

1) Burimet janë kullota kodrinore pranë fshatit Janjar, Sarandë.

2) Gusht' halë është shpat i malit Shëndëlli.

3) Vend me lisa dhe me burime uji në malin Shëndëlli, tek i cili
verojnë bagëtia.

ERDHI PRANVERA

Iku dimri erdhi vera
lulzoi vendi si ngahera,
jeshiloi bari në treva,
manushaqet nëpër ferra.
Çelin pemët dhe tërfili,
lëshon gonxhe trëndafili,
këndon qyqja dhe bilbili
n'ato pllaja dhe lëndina
lulëzon vendi trëndelina.
Po të dalësh n'ato brinja
do të dëgjohen blegërima,
dhi e dhen, kecër e qingja.
Po të dalësh poshtë në fushë
djem e vajza si arushë,
punojnë me gaz e gara,
planin ta kryejnë përpara.
Lulëzohu, fshati ynë,
se në krye ke Partinë!

S A R A N D A

Buzë detit, rrëzë malit,
ku vjen er' e portokallit,
gjëndet lulja e beharit:
Saranda, shërim i xhanit.

Nga çdo an' gjëmon hareja,
pallate, shkolla të reja,
bulevarde dhe bahçera,
hoteli dhe mjaft të tjera.

Po të dalësh nga Ksamili,
së pari s'të ngopet syri,
të kënaq me zë bilbili,
rritet bari dhe tërfili,
portokallja dhe ulliri.

Pun' e madhe për çudi,
ky artist, njeriu i ri
të ka veshur me stoli.
Sarandë moj bukuri,
kush të sheh të ka zili!

P È R M B A J T J E

Rilindasve	3
Naim Frashërit	4
O Ju trima të dëgjuar	5
Viti 1911	6
Në vitin dymbëdhjetë	8
Ky viti 1914	9
Selam Musai	11
Kujton populli Salinë	13
Lufta e Vlorës	14
Kapedan Sali Vranishti	15
Avni Rustemit	16
Kongresit të Lushnjës	17
Trimit të malësisë, Bajram Currit	18
Kur bëri thirrje Partia	19
Dëshmorit Veliko Rexho	20
Luftës së Konispolit	21
Dëshmorëve të Mursisë	23
Çetës së Bregut të Detit	24
Dëshmorit Ferik Çarçani	25
Dëshmorit Mehmet Bejdo	26
Dëshmorit Sadik Xhepe	27
Tre dëshmorëve nga Shalësi	28
Dëshmorit komunist Seit Gaçi	29
Dëshmorit Selman Xhallari	30
Dëshmorit Maliq Tena	31

Lefter Talos	32
Kongresit të Përmetit	33
Faslli Ramadani	34
Komisarit Mustafa Matohiti	35
Konispolit	36
Të dua, fshati im	38
Shqipëri 30 vjeçare	39
O Vuno, fshati me famë	40
Krahina jonë lulëzon	41
Hodha sytë e shikoj fshanë	43
Kam zili për bagëtinë	44
Saranda	46